



NXITJA E PUNËSIMIT PËRMES MENTORIMIT SOCIAL NË SHQIPËRI

Gjatë vitit 2025, GADC vazhdoi zbatimimin e programit të Mentorimit Social si një mekanizëm inovativ për fuqizimin ekonomik dhe integrimin në tregun e punës të grave dhe vajzave nga grupe të marginalizuara. Programi ndërtoi mbi rezultatet e fazave të mëparshme (2023–2024), duke konsoliduar metodologjinë e mentorimit social si një qasje efektive për mbështetje të individualizuar dhe zhvillim të qëndrueshëm profesional.

Faza e vitit 2025 u fokusua në mbështetjen intensive të përfituesve përmes mentorimit të strukturuar, bashkëpunimit institucional dhe krijimit të rrugëve konkrete drejt punësimit dhe vetëpunësimit.

AKTIVITETET KRYESORE GJATË VITIT 2025

- Zbatimi i ciklit të mentoringut social me mentorë të trajnuar
- Mbështetje individuale për përfituesit përmes planeve të personalizuar të zhvillimit profesional
- Bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi dhe Bashkinë Tiranë për referime dhe shërbime mbështetëse
- Supervizim profesional dhe psikologjik për mentorët socialë
- Mbështetje materiale dhe pajisje për raste të vetëpunësimit
- Trajnime profesionale të targetuara sipas nevojave individuale

REZULTATET DHE NDIKIMI

- **26** përfitues të përfshirë në program (96% gra)
- **22** gra përfunduan ciklin e plotë të mentorimit
- **7** mentorë socialë të angazhuar në mënyrë aktive
- **20** përfitues arritën angazhim ekonomik:
 - 15** në punësim të paguar
 - 5** në vetëpunësim

IMPAKTI STRATEGJIK

Faza e tretë e implementimit konfirmoi mentorimin social si një model efektiv për integrimin në tregun e punës të grave nga grupe të cenueshme. Rezultatet e arritura gjatë vitit 2025 kontribuan gjithashtu në ndarjen e përvojës dhe praktikave të mira në nivel rajonal në Ballkanin Perëndimor, duke promovuar mentoringun social si një qasje të transferueshme për fuqizimin ekonomik dhe përfshirjen sociale.